

Emertimi dhe Forma ligjore:
NIPT –i:
Adresa e Selise:
Data e krijimit:
Veprimtaria Kryesore:

“TRIANGLE MEDIA PRODUCTION” sh.p.k
L11913017I
TIRANE
23/11/2009
STUDIO AUDIO VIDEO

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2018

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2018-31.12.2018
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 24.03.2019



Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivet afatshkurtra			
Aktivet monetare	4	39,029,112	27,977,793
Investime			
Të drejta të arkëtueshme			
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		6,721,988	6,929,242
<i>Tvsh kreditore</i>			25,652
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>			
<i>Te tjera</i>			
Totali I te drejtave te arketueshme	5	6,721,988	6,954,894
Inventarët		-	-
<i>Mallra</i>			
<i>Parapagime per inventar</i>			
Totali I inventarit		-	-
Shpenzime të shtyra			
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
Totali I aktiveve afatshkurtra		45,751,100	34,932,687
Aktive afatgjata			
Aktive financiare			
Aktivet materiale			
<i>Ndertesa</i>			
<i>Te tjera, makineri e pajisje</i>		2,040,739	2,660,761
Totali I aktiveve materiale	6	2,040,739	2,660,761
Aktivet biologjike			
Aktive jo materiale:			
Aktive tatimore të shtyra			
Kapitali i nënshkruar i papaguar			
Totali I aktiveve afatgjata		2,040,739	2,660,761
Total Aktive		47,791,839	37,593,448

Administratori

Genc Gjineci



Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		3,593,166	2,419,163
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		2,696,339	1,362,775
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		2,616,509	624,534
<i>Te pagueshme ndaj institucioneve te kredise</i>			
Shuma detyrime afatshkurtra	7	8,906,014	4,406,472
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		8,906,014	4,406,472
Detyrime afatgjata:			
<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>		-	-
<i>Të ardhura të shtyra</i>		-	-
<i>Provizione</i>		-	-
<i>Detyrime tatimore të shtyra</i>		-	-
Total detyrime afatgjata		-	-
Total detyrime		8,906,014	4,406,472
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		17,630,000	17,630,000
<i>Rezerva ligjore</i>		5,479	5,479
<i>Rezerva statutore</i>			
<i>Rezerva të tjera</i>		15,551,497	13,555,239
<i>Fitim i pashpërndarë</i>		-	-
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		5,698,849	1,996,258
Total kapitali aksionar	8	38,885,825	33,186,976
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		47,791,839	37,593,448

Administratori

Genc Gjineci



Pasqyra e performances	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	9	43,349,044	25,477,543
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		-	
<i>Të tjera shpenzime</i>		-	
Shpenzime të personelit	10	(3,670,391)	(3,672,605)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(3,270,465)	(3,270,446)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(399,926)	(402,159)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11	(651,772)	(707,506)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12	(29,133,382)	(18,070,131)
Të ardhura të tjera		-	
<i>Të ardhura nga investimi dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësite ekonomike brenda grupit)</i>		-	
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare		-	
Shpenzime financiare	13	(3,143,269)	(588,510)
<i>Shpenzime për interesa</i>		-	
<i>Të ardhura dhe humbje nga kembimet valutore</i>		(2,884,285)	(77,077)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		(258,985)	(511,433)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	
Fitimi/Humbja para tatimit	14	6,750,231	2,438,792
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14	(1,051,382)	(442,534)
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>		(1,051,382)	(442,534)
Fitimi/Humbja e vitit	14	5,698,849	1,996,258
Te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	14	5,698,849	1,996,258

Administratori

Genc Gjineci



(metoda indirekte)

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		6,750,231	2,438,790
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		651,772	707,500
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		-	
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		-	
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		232,906	5,105,120
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		-	
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		3,448,160	(5,403,129)
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		-	
<i>Tatim fitimi I paguar</i>			(468,186)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		11,083,068	2,380,100
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(31,750)	(804,895)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(31,750)	(804,895)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
<i>Pagese e detyrimeve te huave</i>		-	
<i>Interes i paguar</i>		-	
<i>Dividendë të paguar</i>		-	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		-	
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		11,051,319	1,575,200
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		27,977,793	26,402,580
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		39,029,112	27,977,790

Administratori

Genc Gjineci



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	5,500,000	12,135,479	13,555,239	31,190,718
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël				
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			1,996,258	1,996,258
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:				
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike		13,555,239	(13,555,239)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	5,500,000	25,690,718	1,996,258	33,186,976
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Fitimi / Humbja e vitit			5,698,849	5,698,849
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:				
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike		1,996,258	(1,996,258)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	5,500,000	27,686,976	5,698,849	38,885,825

Administratori

Genc Gjineci



SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria është regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Rregjistrimit në datë 13.07.2011. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 5.500.000 leke dhe zotërohet dhe administrohet nga ortakët i vetëm Z. Genc Gjineci. Objekti i veprimtarisë është prodhim reklama Audio Vizuale, radio.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	135.23
USD/ LEK	107.82	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi



flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.


- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.



Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme


Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%



iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe

detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivet

4. Aktive monetare

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2018 eshte ne shumen 39,029,112 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Aktive monetare	39,029,112	27,977,793
	Totali	39,029,112	27,977,793

Diferencat e konvertimit janë kompesuar te te ardhurat dhe shpenzimet dhe janë marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Ne kete post paraqiten te drejta te arketueshme me 31.12.2018 ne shumen 6,721,988 leke, si me poshte:

8. Kapitali

Shoqeria ka kapital te regjistruar ne shumen 17,630,000 leke. Kapitalet e veta jane shtuar me fitimin e vitit ushtrimor 2018 ne shumen 5,698,849 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2018 eshte 38,885,825 leke. Levizja e grupit te kapitaleve te veta per vitin 2018 paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali i nenshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2017	17,630,000	5,479	13,555,239	1,996,258	33,186,976
2	Shtesat per 2018	-	-	1,996,258	5,698,849	7,695,107
3	Paksimet per 2018	-	-	-	(1,996,258)	(1,996,258)
	Gjendja me 31.12.2018	<u>17,630,000</u>	<u>5,479</u>	<u>15,551,497</u>	<u>5,698,849</u>	<u>38,885,825</u>

Pasqyra e Te Ardhurave Dhe Shpenzimeve

9. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne kete post jane rregjistruar shitjet per sherbimet e ofruara te cilat jane realizuar per vitin 2018 ne shumen 43,349,044leke.

Nr	Pershkrimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga shitja e sherbimeve	43,349,044	25,477,543
	Shuma	<u>43,349,044</u>	<u>25,477,543</u>

10. Kostot e punes

Shpenzimet per personelin per vitin 2018 paraqiten ne shumen 3,670,391 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime per paga	3,270,465	3,270,446
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	399,926	402,159
	Shuma	<u>3,670,391</u>	<u>3,672,605</u>

11. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Amortizimi vjetor i aktiveve afat gjata materiale eshte llogaritur ne shumen 651,772 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Amortizimi I asetëve	651,772	707,506
	Shuma	<u>651,772</u>	<u>707,506</u>

12. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Jane perfshire shpenzime te cilat i perkasin vitit 2018, ne shumen 29,133,382 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Sherbim Transmetimi	19,026,859	13,620,008
3	Qira	636,000	636,000
4	Shpenzim telefonik, interneti	692,370	703,929
5	sherbime bankare	29,821	18,167
6	Taksa vendore	47,000	47,000
7	Dieta per personelin	6,236,000	526,420
8	Tarife rinovimi AMA	348,000	311,800



Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2018	Viti 2017
1	Nga aktiviteti I shfrytezimit	6,721,988	6,929,242
2	Tatim fitimi	-	25,652
	Totali	<u>6,721,988</u>	<u>6,954,894</u>

6. Aktive afat gjata materiale

Gjendja e aktiveve eshte paraqitur me vleren kontabel te mbetur, ne shumen 2,040,739 leke si me poshte:

Nr	Aktivitet materiale	Viti 2018	Viti 2017
1	Pajisje zyre dhe informatike	2,040,739	2,660,761
	Shuma	<u>2,040,739</u>	<u>2,660,761</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018.

Tabela e detajuar e asetëve është bashkangjitur ketyre pasqyrave financiare.

Bilanci kontabel, pasivet

7. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2018 ne shumen 8,906,014 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2018	Viti 2017
1	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	3,593,166	2,419,163
2	Të pagueshme ndaj punonjësve	2,696,339	1,362,775
3	Të pagueshme për detyrimet tatimore	2,616,509	624,534
	Totali I detyrimeve	<u>8,906,014</u>	<u>4,406,472</u>

7.1 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Paraqitet gjendja furnitoreve e palikujduar ne shumen 3,593,166 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2018 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.


7.2 Te pagueshme ndaj punonjesve

Ne kete ze eshte perfshire gjendja e pagave te palikujduara me 31.12.2018 ne shumen 2,696,339 leke.

7.3 Detyrime tatimore

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj shtetit me 31.12.2018, ne shumen 2,616,509 leke, si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2018	Viti 2017
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	71,108	80,504
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	37,739	24,726
3	Tatim mbi vleren e shtuar	1,473,982	364,166
4	Tatim fitimi sipas bilancit	1,025,730	-
5	Tatim ne burim	7,950	155,138
	Totali I detyrimeve	<u>2,616,509</u>	<u>624,534</u>



[Handwritten signature in blue ink]

9	Sigurime	-	900
10	Te drejta autori	-	1,813,164
11	Te tjera	451,974	392,742
12	Bileta udhetimi	1,665,357	
	Shuma	<u>29,133,382</u>	<u>18,070,131</u>

13. Shpenzime financiare

Jane paraqitur te shpenzime financiare ne shumen 3,143,269 leke per vitin 2018, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Gjoha e penalitete	258,985	2,967
2	Fitime/Humbje nga kursi I kembimit	2,884,285	77,077
3	Humbje nga mosarketimi I klientit		508,466
	Shuma	<u>3,143,269</u>	<u>588,510</u>

14. Llogaritja e tatimit te fitimit

Shoqeria per vitin 2018 paraqitet me fitim ne shumen 5,698,849 leke, shpenzime te pazbritshme 258,985 leke.

Nr	EMERTIMI	VITI 2018	VITI 2017
1	Te ardhura	43,349,044	25,477,543
2	Shpenzime	(36,598,813)	(23,038,752)
3	Rezultati	<u>6,750,231</u>	<u>2,438,792</u>
4	Shpenzime te pazbritshme	<u>258,985</u>	<u>511,433</u>
	b) Gjoha e penalitete	258,985	2,967
	c) Humbje nga mosarketim klienti	-	508,466
5	Rezultati tatimor	<u>7,009,216</u>	<u>2,950,224</u>
6	Tatim fitimi	1,051,382	442,534
7	Fitimi neto	<u>5,698,849</u>	<u>1,996,258</u>

15. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

16. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Genc Gjineci



[Handwritten signature in blue ink]